

# Statistikat afatshkurtra\*

## Prodhuesit e të mirave - Tremujori III 2020


**Tiranë, më 16 Dhjetor 2020:** Treguesit tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim.

### Industria

Indekset e treguesve në aktivitetin Industri, në tremujorin e tretë 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 3,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 10,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënie 8,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Industri (%)




Për publikim 16/12/2020

### Energji elektrike, Gaz, Avull

Indekset e treguesve në aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull, në tremujorin e tretë 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 4,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 2,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 0,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 12,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig.2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Energji elektrike, Gaz, Avull (%)




### Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Indekset e treguesve në aktivitetin Furnizimi me ujë dhe Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e tretë 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 3,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 6,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Furnizimin me ujë, Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve (%)




**Ndërtimi**

Indekset e treguesve në aktivitetin Ndërtim, në tremujorin e tretë 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 16,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 14,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto, Ndërtim (%)



**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.III 2020 (2015=100)	III.20 / III.19 (%)	Tr.III 2020 (2015=100)	III.20 / II.20 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>108,0</b>	<b>-3,5</b>	<b>103,7</b>	<b>20,6</b>
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	60,9	-18,2	61,5	12,6
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	132,1	0,5	123,9	22,9
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	108,1	-4,6	118,2	16,6
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	100,2	3,1	99,3	32,0
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>148,3</b>	<b>16,5</b>	<b>148,1</b>	<b>15,1</b>
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	129,2	3,5	127,6	25,7
		Energji	83,4	-7,7	88,3	17,7
		Mallra kapitale	124,5	-0,5	121,8	12,1
		Mallra të qëndrueshme konsumi	120,7	-1,2	115,2	39,3
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	121,0	-8,8	110,4	15,6

**Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.III 2020 (2015=100)	III.20 / III.19 (%)	Tr.III 2020 (2015=100)	III.20 / II.20 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>100,9</b>	<b>-1,8</b>	<b>97,4</b>	<b>22,7</b>
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	66,1	-12,5	68,2	23,2
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	127,2	2,1	118,1	19,4
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	56,3	2,3	69,4	31,2
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	100,7	0,8	100,4	33,9
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>153,4</b>	<b>14,8</b>	<b>153,1</b>	<b>17,6</b>
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	119,5	9,2	118,5	24,1
		Energji	54,9	-6,3	63,2	36,3
		Mallra kapitale	148,4	-1,0	141,8	11,6
		Mallra të qëndrueshme konsumi	126,6	0,0	116,3	35,1
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	119,9	-4,9	111,4	17,0

**Tab. 3 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Numri i të të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.III 2020 (2015=100)	III.20 / III.19 (%)	Tr.III 2020 (2015=100)	III.20 / III.19 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>103,9</b>	<b>-10,8</b>	<b>118,0</b>	<b>-8,6</b>
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	79,9	-15,9	93,9	-16,8
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	107,5	-10,2	127,2	-6,4
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	113,4	-0,2	175,7	12,2
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	125,1	6,3	148,9	10,9
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>119,9</b>	<b>3,2</b>	<b>130,6</b>	<b>2,7</b>

# Metodologjia

## Informacion

**Në tremujorin e tretë (Korrik – Shtator) 2020, me marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së COVID-19, INSTAT ka ndërprerë intervistat direkte në ndërmarrje dhe për të vlerësuar treguesit tremujor të ndërmarrjeve ka përdorur metodën e kombinuar: burime administrative dhe intervista me telefon të ndërmarrjeve. Të dhënat janë objekt rishikimi.**

Në vazhdim të përpjekjeve të përafritimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikave evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Të mira si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2017, realizuar nga INSTAT.

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

## Në prodhuesit e të mirave:

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Për këtë tremujor është përdorur burimi administrativ dhe metoda e kontaktit me telefon të ndërmarrjeve.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

*Ndryshimi tremujor në përqindje* - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

### **Përkufizimet e treguesve kryesorë**

*Shitjet neto* - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i shitjeve neto* - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

*Numri i të punësuarve me pagesë* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

**Grupimet Industriale Kryesore** janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 07-09 Nxjerrja e mineraleve natyrore; Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare</li> <li>• 13000 Përpunimi i tekstileve</li> <li>• 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve</li> <li>• 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre</li> <li>• 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike</li> <li>• 22000 Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës</li> <li>• 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike</li> <li>• 24000 Metalurgjia</li> <li>• 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve</li> <li>• 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike</li> </ul>
Energji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 05-06 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror</li> <li>• 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës</li> <li>• 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar</li> </ul>
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore</li> <li>• 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike</li> <li>• 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t</li> <li>• 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve</li> </ul>
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët</li> <li>• 31000 Prodhimi i mobiljeve</li> <li>• 32XXX Industri të tjera p.k.t</li> </ul>
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore</li> <li>• 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit</li> <li>• 14000 Konfeksionimi i veshjeve</li> <li>• 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure</li> <li>• 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara</li> <li>• 32YYY Industri të tjera p.k.t</li> </ul>

### Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori III 2020. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit, komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.